UDHËZIM
Nr. 188, datë 27.9.2024

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR LIDHJEN E MARTESËS DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË MBAHET NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE PËR LIDHJEN E SAJ, SI DHE PËR NDRYSHIMIN E MBIEMRIT, KUR NDODH PËR SHKAK TË MARTESËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 6, të nenit 47, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Kërkesa për shpallje martese bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar *"e-Albania"* dhe në rast të pamundësisë objektive për të përdorur këtë portal, kërkesa mund të bëhet pranë zyrave të gjendjes civile nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga një përfaqësues i tyre i autorizuar me prokurë të posaçme. Në këtë prokurë duhet të specifikohet qartë veprimi që përfaqësuesi është i autorizuar të kryejë pranë shërbimit të gjendjes civile.

2. Kjo kërkesë i drejtohet zyrës së gjendjes civile në bashki/njësinë administrative ku janë të regjistruar bashkëshortët e ardhshëm.

3. Në rast se të dy bashkëshortët janë të regjistruar në të njëjtën bashki/njësi administrative, zyra e gjendjes civile kryen 1 (një) shpallje martese. Për rastet kur bashkëshortët e ardhshëm rezultojnë në 2 (dy) bashki/njësi administrative të ndryshme, ata paraqesin kërkesën për shpallje në zyrën ku kanë vendbanimin respektivisht. Secila zyrë e gjendjes civile kryen shpalljen e martesës për bashkëshortin që ka vendbanimin në bashkinë/njësinë administrative të saj.

4. Nëse njëri nga bashkëshortët është shtetas i huaj, në kërkesën për lidhjen e martesës duhet të specifikohet njohja ose jo e gjuhës shqipe. Në rast se konfirmohet njohja e gjuhës shqipe, lidhja e martesës do të kryhet pa praninë e përkthyesit. Në të kundërt, nëse shtetasi i huaj nuk njeh gjuhën shqipe, martesa do të lidhet në prani të një përkthyesi të autorizuar.

5. Shtetasit mund të aplikojnë për një shpallje tjetër martese pasi ka kaluar afati i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, apo nëse kanë refuzuar ose anuluar shpalljen e mëparshme.

6. Dokumentet që duhet të paraqesë shtetasi i huaj që kërkon të shpallë martesë janë:

a) fotokopje pasaporte/dokument udhëtimi;

b) certifikatë lindje me të dhëna të plota, përfshirë të dhënat e prindërve dhe rubrikën e gjendjes civile, statusin, në përputhje me legjislacionin në fuqi të përkthyer dhe të apostiluar/legalizuar sipas rastit. Shtetasit e huaj të cilët kanë vendbanimin e tyre në një shtet që është në konflikt dhe e kanë objektivisht të pamundur marrjen e dokumentit të përcaktuar, nga ana e tyre do të paraqitet deklaratë noteriale që vërteton të dhënat e këtyre shtetasve;

c) dokument që vërteton vendbanimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi të përkthyer dhe të apostiluar/legalizuar sipas rastit, në rast se shtetasi nuk ka vendbanim në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC).

7. Zyra e gjendjes civile në të cilën është paraqitur kërkesa për shpalljen e martesës vlerëson dokumentacionin e paraqitur për procedurën e shpalljes nga bashkëshortët ose personi i caktuar nga ato me prokurë.

8. Nëpunësi i gjendjes civile në të cilën është paraqitur kërkesa për shpalljen e martesës vlerëson nëse rezultojnë pengesa ligjore për shpalljen e martesës.

9. Zyrat përkatëse të gjendjes civile, ku është paraqitur kërkesa për shpallje kryejnë afishimin e shpalljes në vende të dukshme të përcaktuara nga bashkia/njësia administrative, për arsye transparence, me qëllim informimin e palëve të treta.

10. Pas kalimit të afatit 10- ditor (dhjetëditor) nga shpallja e martesës, për rastet kur martesa do të lidhet jashtë vendit, zyra e gjendjes civile, për shtetasit shqiptar, lëshon dokumentin leje për lidhje martese për përdorimin nga autoritetet e huaja.

11. Në rastet kur në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësinë administrative paraqitet akt kundërshtimi nga personat e legjitimuar për këtë kundërshtim, në përputhje me legjislacionin në fuqi, zyra e gjendjes civile pezullon procedurën e lidhjes së martesës, duke lëshuar aktin e refuzimit sipas formatit të miratuar. Shtetasi njoftohet për këtë veprim nga zyra përkatëse e gjendjes civile.

12. Martesa lidhet me pëlqim të lirë dhe me paraqitjen e bashkëshortëve përpara nëpunësit të gjendjes civile ose në misionet diplomatike dhe postet konsullore, sipas përcaktimeve në kërkesën e tyre, vetëm pasi është plotësuar por nuk është tejkaluar afati i shpalljes së martesës, mes një burri dhe një gruaje që ka mbushur moshën 18 vjeç. Martesa nën këtë moshë lejohet vetëm në rastet e parashikuara nga Kodi i Familjes.

13. Dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e martesës është:

a) letërnjoftimi ose çdo dokument identifikimi i bashkëshortëve;

b) lejen për lidhjen e martesës ku konfirmohet që shtetasi me shtetësi shqiptare nuk ka pengesë ligjore për lidhjen e martesës, në rastet kur martesa do të lidhet në misionet diplomatike dhe postet konsullore;

c) leje për lidhjen e martesës ose dokument në përputhje me legjislacionin në fuqi të shtetit të huaj, ku konfirmohet që shtetasi i huaj nuk ka pengesë ligjore për lidhjen e martesës jashtë vendit, të përkthyer dhe të apostiluar/legalizuar. Për shtete që nuk e lëshojnë këtë dokument, paraqitet dokument konsullor nga përfaqësia diplomatike e shtetit të huaj, në përmbajtje të së cilit konfirmohet se shtetasi i huaj nuk ka pengesë ligjore për të lidhur martesë. Shtetasit e huaj të cilët kanë vendbanimin e tyre në një shtet që është në konflikt dhe e kanë objektivisht të pamundur marrjen e dokumentit leje për lidhje martese, nga ana e tyre do të paraqitet deklaratë noteriale që nuk ka pengesa ligjore për lidhje martese.

14. Përpara kryerjes së veprimeve për lidhjen e martesës, nëpunësi i gjendjes civile ndjek me përpikëri veprimet e mëposhtme:

a) sigurohet për identitetin e bashkëshortëve të ardhshëm;

b) përcakton mbiemrin që do të mbajë secili nga bashkëshortët me lidhjen e martesës, në përputhje me Kodin e Familjes;

c) përcakton vendbanimin e përbashkët sipas marrëveshjes së bashkëshortëve;

ç) në rast se kanë fëmijë të lindur jashtë martese, udhëzon bashkëshortët për të drejtën për njohjen e atësisë së fëmijëve me lidhjen e martesës. Në këto raste, akti përmban dy deklarime, atë të bashkimit në martesë dhe të njohjes së atësisë vullnetare të fëmijës;

d) regjistron kontratën e regjimit të pasurive, sipas depozitimit;

e) kryen verifikime nëse bashkëshortët e ardhshëm kanë në përbërjen e tyre familjare: fëmijë të mitur, të lindur jashtë martese ose nga martesa të mëparshme pasi këta fëmijë do të rezultojnë në të njëjtën familje të bashkëshortëve të ardhshëm që do të krijohet me lidhjen e martesës, sipas përditësimit përkatës të relacionit familjar, marrëdhënies me kryefamiljarin.

15. Në rastet kur njëri prej bashkëshortëve ndryshon mbiemrin, nëpunësi i gjendjes civile raporton në rrugë shkresore pranë strukturës përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit, kur krijon bindjen se:

a) bashkëshortët nuk janë takuar përpara se të lidhin martesë dhe nuk kanë qëllim jetesën e përbashkët;

b) bashkëshortët nuk janë në gjendje të japin informacion për të dhënat e njëri-tjetrit në rast se pyeten nga nëpunësi i gjendjes civile;

c) ka prova të një martese fiktive të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër;

ç) për arsye të numrit të martesave të mëparshme, të zgjidhura që mund të ketë lidhur secili nga bashkëshortët;

d) për arsye të diferencës së madhe të moshës midis bashkëshortëve, si dhe çdo dyshim tjetër i arsyeshëm që martesa mund të lidhet me qëllim të vetëm ndryshimin e identitetit.

16. Në rastet kur të njëjtët shtetas, të cilët kanë lidhur martesën dhe zgjidhur atë, kërkojnë të rilidhin përsëri të njëjtën martesë dhe zgjedhin mbiemër të përbashkët të ndryshëm nga ai i zgjedhur në martesën e parë, zyra e gjendjes civile raporton rastin në rrugë shkresore pranë strukturës përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit.

17. Nëpunësi i gjendjes civile mund të refuzojë lidhjen e martesës vetëm për shkaqe të parashikuara në Kodin e Familjes.

18. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile të njësisë administrative kryen veprimet për lidhjen e martesës vetëm pasi plotësohen parashikimet ligjore.

19. Pas lidhjes së martesës, duke mbajtur aktin e martesës nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet përkatëse të përditësimit të të dhënave të bashkëshortëve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, për:

a) përditësimin e marrëdhënies me kryefamiljarin, sipas rastit kur në familje është shtuar bashkëshorti ose bashkëshortja, fëmijë të mitur që bashkëshorti/bashkëshortja mund të kenë nga martesa të mëparshme, ose fëmijë para martese për të cilët është njohur atësia, bazuar në mundësitë që përzgjidhen në RKGJC, si dhe përditësimi i rubrikës për ndryshimin e numrit të votimit, duke plotësuar dhe përshkrimin sipas arsyes: *"Bashkuar në familje me lidhjen e martesës, në bazë të aktit nr. ___, datë __ . ___ . ___"*, në mënyrë që këto të dhëna të jenë të njëjta për të gjithë anëtarët e familjes;

b) pas mbajtjes së aktit të martesës, plotësohen të gjitha rubrikat me informacionin përkatës.

20. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësinë administrative, shërbimi i gjendjes civile në misione diplomatike dhe poste konsullore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha